

Projekti është i financuar nga “Fondacioni Shoqëri e hapur – Maqedoni”

## Observatori për reforma mediatike

### Raporti i dytë periodik nga vëzhgimi i përmbushjes së reformave prioritare nga fusha e mediave

Periudha e raportimit: 01.10.2017 – 31.12.2017

Ky raport është rezultat i procesit të vëzhgimit të realizimit të reformave prioritare (RUP) nga fusha e mediave në kuadër të projektit “Observatori për reforma mediatike”, të cilin e realizojnë Fondacioni “Metamorfozis”, “Agora” dhe PINA. Projekti është i mbështetur nga “Fondacioni Shoqëri e hapur në Maqedoni (FSHHM).

Të gjitha materialet që janë produkt i këtij projekti dhe i vëzhgimit të realizuar gjenden në ueb-faqen e veçantë të dizajnuar për nevojat e projektit. Ueb-faqja është: [mediaobservatorium.mk](http://mediaobservatorium.mk)

shkurt 2018

Informatat dhe qëndrimet e publikuara nuk i paraqesin qëndrimet zyrtare të Fondacionit Shoqëri e hapur - Maqedoni.

Projektin “Observatori për reforma mediatike”, e realizon Fondacioni për internet dhe shoqëri “Metamorfozis”, në partneritet me SHQ “Agora” – Qendra për promovimin e vlerave qytetare dhe PINA – Platforma për gazetari hulumtuese dhe analiza.

## Përmbajtja

Përmbledhje e shkurtër .....	3
Hyrje.....	4
Qëllimet dhe metodologjia e vëzhgimit.....	5
Qëllimi dhe metodat e raportit.....	5
Hulumtimi .....	6
Raportet e Grupit të ekspertëve të pavarur me përvojë, të udhëhequr nga R. Pribe.....	7
Konstatimet kyçe nga vëzhgimi .....	8
1. Transmetuesi publik i radiodifuzionit .....	8
2. Reklamimi qeveritar .....	11
3. Qasja te informatat .....	13
4. Shpifja .....	15
Literatura e shfrytëzuar .....	16

### Shkurtesat

RM – Republika e Maqedonisë;

BE – Bashkimi Evropian;

KE – Komisioni Evropian;

RUP – Reformat urgjente prioritare; reformat prioritare;

ASHAAM – Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike;

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

### Fjalët kyçe

Media-vëzhguese, media-vëzhgim, reformat prioritare (urgjente), Pribe, mediat, transmetuesi publik i radiodifuzionit, reklamimi qeveritar, qasja te informatat, shpifja.

### Vërejtje

Teksti është përgatitur në kuadër të projektit “Observatori për reforma mediatike”, të cilin e realizojnë Fondacioni për internet dhe shoqëri “Metamorfozis”, “Agora” – Qendra për promovimin e vlerave qytetare dhe Platforma për gazetari hulumtuese dhe analiza (PINA), me mbështetje financiare të “Fondacionit Shoqëri e hapur – Maqedoni”.


Periudha e përfshirë me këtë raport periodik pjesërisht përputhet me periudhën e përfshirë me raportin paraprak të këtij projekti, me qëllim të harmonizimit të ritmit për raportim të të gjitha raporteve në nivel tremujor.

Përmbajtja e tekstit është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e “Fondacionit Shoqëri e hapur – Maqedoni”.

## Përmbledhje e shkurtër

Ky raport periodik i prezanton rezultatet nga vëzhgimi i përbushjes së Reformave urgjente prioritare (RUP) që kanë të bëjnë me lirinë e të shprehurit, në periudhën prej 1 tetorit deri më 31 dhjetor të vitit 2017, në kuadër të projektit “Observatori për reforma mediatike”, të cilin e realizojnë Fondacioni për internet dhe shoqëri “Metamorfozis”, “Agora” – Qendra për promovimin e vlerave qytetare dhe Platforma për gazetari hulumtuese dhe analiza (PINA), me mbështetje financiare të “Fondacionit Shoqëri e hapur – Maqedoni”.

Si rezultat i vëzhgimit të katër shtyllave të RUP, u përcaktuan këto konstatime kyçe:

- **Transmetuesi publik i radiodifuzionit** – ndryshimet e filluara në legjislacionin që ka të bëjë me mediat, me të cilat përcaktohet stabiliteti financiar i transmetuesit publik të radiodifuzionit janë vetëm një pjesë e reformave të nevojshme me qëllim të profesionalizimit, zhvillimit teknik-teknologjik, programor dhe kadrovik të RTM-së. Me këtë rast, vlerësohet se masa që është miratuar tani do të çojë në kufizim drastik të buxhetit të tij. Poashtu, mungesa e kuadrove adekuate për kanalin e ri, të katërt, dhe për redaksitë e bashkësive etnike do t’i rrisë kërkesat financiare ndaj buxhetit edhe ashtu të kufizuar të RTM-së. 
- **Reklamimi i qeveritar** – Pasi i hoqi reklamën e saj në mediat e vendit dhe paralajmëroi se komunikimin e mëtutjeshëm me publikun do ta bëjë nëpërmjet transmetuesit publik dhe mediave sociale, qeveria nuk ofroi sqarime të detajuara për një sërë aspektesh të veçanta për të siguruar transparencë të plotë dhe llogaridhëne, duke publikuar rregullore, procedura apo protokolle. 
- **Qasja te informatat** – Qeveria siguroi qasje falas për gazetarët në të dhënat e dy institucioneve që kanë baza të të dhënave me interes publik dhe filloi konsultime për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik. 
- **Shpifja dhe ofendimi** – Në këtë fushë nuk kishte asnjë ndryshim apo ndonjë lëvizje në periudhën e ndjekjes dhe të raportimit. Nuk është ndërmarrë iniciativë për ndryshimin e Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim dhe të rregullave procedurale me qëllim që të harmonizohen me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Qeveria nuk ka publikuar masa për mbështetjen e mekanizmave për vetërregullim, e as që ka filluar koordinimi me ekspertët në këtë drejtim. 

Observatori për reforma mediatike do të vazhdojë me ndjekjen e realizimit të Reformave urgjente prioritare edhe në periudhën e ardhshme, duke i prezantuar rezultatet në formë të raporteve periodike, lajmeve dhe storjeve hulumtuese, me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në proceset demokratike. Të gjitha rezultatet nga ndjekja e realizimit të reformave gjenden në ueb-faqen [MediaObservatorium.mk](http://MediaObservatorium.mk) në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

## Hyrje

Projekti “Observatori për reforma mediatike” mundëson qasje për publikun në realizimin e proceseve reformuese në fushën e lirisë së të shprehurit, të cilat dalin nga dokumentet e miratuara nga faktorët politikë të vendit dhe bashkësia ndërkombëtare, me qëllim të zgjidhjes së krizës shumëvjeçare politike në RM, e cila e arriti kulminacionin në vitin 2015.

Siç është sqaruar në [Raportin e parë periodik të projektit](#)<sup>1</sup>, reformat bazohen në raportin e [parë](#)<sup>2</sup> dhe të [dytë](#)<sup>3</sup> të ekipit të ekspertëve, të udhëhequr nga ish-komisari i BE-së, Rajnhard Pribe, të qershorit të vitit 2015 dhe të shtatorit të vitit 2017, [Reformat urgjente prioritare të BE-së për Maqedoninë – RUP për Maqedoninë](#)<sup>4</sup> dhe në Marrëveshjen e Përzhinës<sup>5</sup> të arritur në korrik të vitit 2015.

RUP përmban pesë kapituj: Sundimi i të drejtës dhe gjyqësia; Depolitizimi i administratës publike; Reformat zgjedhore; Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit anketues për ngjarjet e 24 dhjetorit; dhe Mediat: liria e të shprehurit.

Në RUP, BE-ja thekson se reformat në fushën e mediave dhe lirisë së të shprehurit janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin e pushtetit transparent, demokratik dhe të lirë në vend. Konkretisht, reformat në fushën “Mediat: liria e të shprehurit” kanë për qëllim arritjen e përparimit dhe zgjidhjen e problemeve në katër sfera: transmetuesi publik i radiodifuzionit, reklamimi qeveritar, qasja te informatat dhe shpifja.

Me marrjen e detyrës më 31.05.2017, Qeveria e RM-së në Programin për punë të qeverisë 2017-2020<sup>6</sup>, si dhe në kuadër të planit “3-6-9”<sup>7</sup>, e vërtetoi obligimin se realizimi i RUP-ve është prioritet i saj më i lartë. Në përputhje me këto dokumente, qeveria zotohet se në pjesën e mediave do të ndërtojë partneritet me shoqatat dhe me sektorin qytetar, që ta lirojë hapësirën mediatike nga çfarëdo lloj ndikimi institucional ose personal, duke e përfshirë edhe varësinë financiare.

Me përbushjen e RUP në katër sferat prioritare nga fusha e mediave pritet të krijohen kushte për avancim të mëtutjeshëm të lirisë së të shprehurit në nivel shtetëror, si dhe të krijohet një bazë e cila mundëson reforma të mëtutjeshme institucionale.

---

<sup>1</sup> Observatori për reforma mediatike, Raporti i parë periodik nga vëzhgimi i përbushjes së reformave prioritare nga fusha e mediave <http://mediaobservatorium.mk/wp-content/uploads/2017/11/Raporti ORM 1.pdf>

<sup>2</sup> Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf)

<sup>3</sup> The former Yugoslav Republic of Macedonia: Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues 2017, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14\\_seg\\_report\\_on\\_systemic\\_rol\\_issues\\_for\\_publication.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf)

<sup>4</sup> Reformat urgjente prioritare – përkthim në gjuhën maqedonase: [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent\\_reform\\_priorities\\_mk.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf). Në origjinal në gjuhën angleze: Urgent Reform Priorities for Macedonia, Komisioni Evropian, DGJ Politika evropiane për fqinjësi dhe negociatat për zgjerim, qershor 2015 [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent\\_reform\\_priorities\\_en.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_en.pdf)

<sup>5</sup> Przino Agreement – Agreement in Skopje to overcome political crisis, 2 June 2015, Skopje [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_agreement.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_agreement.pdf)

<sup>6</sup> Programi për punë të qeverisë së RM-së, [http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Programa\\_Vlada\\_RM\\_Juni\\_Dekemvri\\_2017.pdf](http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Programa_Vlada_RM_Juni_Dekemvri_2017.pdf)

<sup>7</sup> Qeveria e RM-së, plani “3-6-9”, <http://vlada.mk/plan-3-6-9>

## Qëllimet dhe metodologjia e vëzhgimit

### Qëllimi dhe metodat e raportit

Ky raport është dedikuar, para së gjithash, për informimin e publikut të gjerë ose qytetarëve për procesin e realizimit të RUP në fushën e mediave, në mënyrë të kuptueshme, të përshtatshme për opinionin e gjerë dhe publikun joekspert. Poashtu, raporti do t'i informojë edhe palët e tjera të interesuara, siç janë mediat, institucionet dhe sektori qytetar.

Raporti ka për qëllim të sigurojë informata adekuate për përparimin e realizimit të reformave të parapara në fushën e mediave.

Ky raport është përgatitur në përputhje me metodologjinë e përgatitur ekskas për vëzhgim, që përfshin një sërë aktivitete dhe masash për mbledhjen e të dhënave dhe për ndjekjen e proceseve të reformave. Metodologjia bazohet në zbatimin e një sërë aktivitete hulumtuese, duke filluar nga analiza e kornizës aktuale juridike dhe analiza e gjendjeve në media dhe me lirinë e të shprehurit, pastaj zbatimin e vëzhgimit ditor dhe periodik, si dhe analizat hulumtuese, organizimin e grupeve të fokusit me persona që kanë informata kyçe etj.

**Hulumtimi në zyrë** është i fokusuar në mbledhjen e të dhënave dhe në analizën e të gjitha dokumenteve relevante që kanë të bëjnë me realizimin e RUP në fushën e mediave, siç janë raportet vjetore të BE-së për Maqedoninë, raportet e Pribes, si dhe dokumentet dhe raportet e institucioneve nacionale ose organizatave që kanë të bëjnë me reformat prioritare të mediave. Këto të dhëna sigurohen nëpërmjet kanaleve të ndryshme të informacioneve, duke i përfshirë edhe rrjetet e bashkëpunëtorëve në sektorin qytetar dhe atë mediatik, si dhe nga vetë institucionet nëpërmjet Ligjit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik.

Për ndjekje më të mirë dhe të rregullt të gjendjeve me realizimin e reformave mediatike, në kuadër të projektit realizohen aktivitete të **vëzhgimit periodik dhe ditor** të ueb-faqeve relevante për përmbajtjet që kanë të bëjnë me reformat mediatike.

Aktivitetet e projektit përfshijnë edhe realizimin e mbledhjeve të dy **grupe të fokusit** që të fitohen informata nga personat dhe ekspertët që kanë informata kyçe nga fushat që kanë të bëjnë me realizimin e RUP-it nga sektori qytetar, akademik, privat dhe ai qytetar. Njohuritë nga grupi i parë i fokusit që u mbajt më 9 tetor të vitit 2017 janë përfshirë në rezultatet e vëzhgimit dhe do të shërbejnë si udhëzime për aktivitetet e mëtejshme për vëzhgim dhe për hulumtime gazetareske.

Për prezantimin e konstatimeve të vëzhgimit, si dhe për të nxitur dialog më të gjerë ndërmjet krijuesve të politikave dhe faktorëve të tjerë ose publikut, parashihen **dy debate publike**, të cilat kanë për qëllim ta kycin shoqërinë qytetare në këto procese.

Rezultatet e vëzhgimit publikohen në formë të **analizave tremujore dhe të analizës përfundimtare**. Në nivel të projektit, këto informata do të plotësohen me **artikuj hulumtues**, nëpërmjet të të cilëve qytetarëve do t'u ofrohen njohuri plotësuese për kontekstin, gjendjet paraprake që kanë çuar në gjendjet aktuale, si dhe obligimet që janë ndërmarrë nga institucionet e RM-së për realizimin e reformave prioritare.

Vëzhgimi realizohet nga ana e një ekipi multi-diciplinar të projektit, të përbërë nga anëtarët e tre organizatave partnere me ekspertizë komplementare (gazetarë, ekspertë mediatikë dhe juristë).

Sipas metodologjisë, aktivitetet hulumtuese konstatojnë katër nivele të realizimit të obligimeve që dalin nga RUP në fushën "Mediat: liria e të shprehurit". Këto katër nivele janë:

1. Fare e porealizuar – asgjë konkrete nuk është filluar.
2. E filluar, mirëpo e porealizuar – kanë filluar aktivitetet për ndryshimin e legjislacionit.

3. Pjesërisht e realizuar – janë bërë ndryshimet ligjore, mirëpo nuk ka filluar implementimi.
4. Plotësisht e realizuar – reformat janë realizuar në tërësi.

Gjatë paraqitjes vizuale, për komunikim më të lehtë me publikun e gjerë, do të përdoren kode me ngjyrë për secilin nga këto nivele të përcaktuara të realizimit (e kuqe, portokalle, e verdhë dhe e gjelbër).

1. Fare e porealizuar – asgjë konkrete nuk është filluar.	
2. E filluar, mirëpo e porealizuar – kanë filluar aktivitetet për ndryshimin e legjislacionit.	
3. Pjesërisht e realizuar – janë bërë ndryshimet ligjore, mirëpo nuk ka filluar implementimi.	
4. Plotësisht e realizuar – reformat janë realizuar në tërësi.	

Fotografia 1: Nivelet e realizimit dhe kodet e ngjyrave.

Aktivitetet për vëzhgimin e gjendjeve i realizon ekipi multi-diciplinar i projektit, i përbërë nga anëtarët e tre organizatave partnere me ekspertizë komplementare (gazetarë, ekspertë mediatikë dhe juristë).

## Hulumtimi

Reformat prioritare nga fusha “Mediat: liria e të shprehurit” parashohin ndërmarrje të një sërë masash dhe aktiviteteve konkrete që duhet t’i ndërmarrin institucionet relevante të vendit me qëllim të arritjes së përparimit drejt demokratizimit dhe qeverisjes së mirë. Këto masa dhe aktivitete janë ndarë në katër shtylla për realizimin e reformave të parapara në fushën e mediave: Transmetuesi publik i radiodifuzionit, reklamimi qeveritar, qasja te informatat dhe shpifja. Në kuadër të secilës nga shtyllat janë paraparë veprime plotësuese që kontribuojnë për realizimin e qëllimit të shtyllës kryesore. Sipas RUP, reformat që duhet të realizohen në këtë sferë janë:

**Transmetuesi publik i radiodifuzionit:** të sigurohen dëshmi të dukshme për reforma në transmetuesin publik të radiodifuzionit në aspekt të politikës së punës, organizimit, edukimit dhe redaksisë dhe mungesës së pavarësisë politike, mungesës së raportimit të balancuar, si dhe sigurimit të përmbajtjeve informative, me cilësi të lartë.

**Reklamimi qeveritar:** të vendosen rregulla të rrepta për reklamim qeveritar të bazuar në kritere transparente, objektive dhe jodiskriminuese; të sigurohet transparencë e plotë e reklamimit qeveritar dhe të zhvillohet mekanizëm për publikime falas në transmetuesin publik, të cilat me të vërtetë janë me interes publik.

**Qasja te informatat:** të trajtohen pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen gazetarët gjatë marrjes së informatave publike.

**Shpifja:** Zvogëlimi i rasteve të shpifjeve duke e ndryshuar legjislacionin, duke i ndryshuar rregullat procedurale, duke e mbështetur dhe duke e promovuar përdorimin më të madh të vetërregullimit si alternativë për procedurën gjyqësore, si dhe garantimi dhe zbatimi, në nivel politik, i praktikimit adekuat të vetëkufizimit nga politikanët dhe funksionarët publikë që të mos iniciohet procedurë për shpifje, në përputhje me parimet e GJEDNJ-së.

## Raportet e Grupit të ekspertëve të pavarur me përvojë, të udhëhequr nga R. Pribe

Ndjekja e implementimit të reformave prioritare bëhet rregullisht nga ana e Komisionit Evropian, gjegjësisht nga grupi i ekspertëve të lartë të pavarur që e formoi KE-ja për ta analizuar situatën dhe për të ofruar rekomandime për çështjet sistematike sa i përket sundimit të të drejtës, e të cilat janë të lidhura me ndjekjen e komunikimeve, që u zbulua në pranverë të vitit 2015.

Raporti i parë i grupit të ekspertëve, i cili u publikua në qershor të vitit 2015, i konstatoi mangësitë dhe problemet kyçe në sferën mediatike në vend dhe dha rekomandime për zgjidhjen e tyre menjëherë pas realizimit të reformave në pushtet dhe në institucione. Problemet kyçe që u përmendën kanë të bëjnë me ndikimin politik dhe financiar mbi transmetuesin publik të radiodifuzionit dhe mbi mediat e tjera, reklamimin qeveritar, qasjen të informatat me karakter publik dhe shpifjen.

Në shtator të vitit 2017, Grupi i ekspertëve të pavarur me përvojë e përgatiti raportin e parë, me të cilin u bë vlerësim i përparimit në trajtimin e konstatimeve dhe të rekomandimeve të tyre paraprake, që u dhanë në raportin e parë në vitin 2015. Me këtë raport, në masë të madhe u konstatuan problemet dhe sfidat paraprake në sferën mediatike dhe lirinë e të shprehurit dhe është konstatuar shkallë e ulët ose e kufizuar e realizimit të reformave të parapara. Duke e pasur parasysh këtë, mbeten të vlejshme edhe më tutje rekomandimet e dhëna në raportin e parë në vitin 2015, e në mënyrë plotësuëse janë dhënë edhe rekomandime të reja. Rekomandimet e reja nga raporti i vitit 2017 kanë të bëjnë me ndërtimin e strategjisë qeveritare për realizimin e reformave në media, të bazuar në analizë adekuate dhe në planifikim në mënyrë transparente dhe pjesëmarrëse me përfaqësuesit e të gjithë faktorëve relevantë nga sektori publik dhe ai privat. Rekomandimet kanë të bëjnë edhe me përmirësimin e kapaciteteve të mediave dhe me përforcimin e rolit të tyre për shtet llogaridhënës, gazetari hulumtuese etj. Rekomandimet e tjera kanë të bëjnë me përmirësimin e funksionimit të “Radiotelevizionit të Maqedonisë” (RTM) në aspekt të pavarësisë së tij dhe udhëheqjes dhe punës efektive, si dhe transparencës dhe llogaridhënies ndaj të gjithë faktorëve. Poashtu, duhet të sqarohet situata me financimin e Agjencisë për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike që të sigurohet pavarësia e saj dhe pavarësia e Këshillit të saj.

Implementimi i RUP, poashtu, është vëzhguar edhe nga organizatat dhe institucionet e tjera ndërkombëtare, si dhe nga sektori qytetar dhe nga mediat në Maqedoni. Konstatimet dhe përfundimet e tyre, në përgjithësi, përputhen me gjendjet e konstatuara dhe problemet edhe sfidat e identifikuara në raportet e Pribes.

Nga ana tjetër, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe institucionet e tjera informojnë për aktivitetet e tyre për realizimin e reformave prioritare. Në periudhën e deritanishme nga analiza e informatave dhe e dokumenteve të tyre vërehet se një pjesë e reformave të parapara janë në realizim e sipër.

Gjatë përgatitjes së raportit nga vëzhgimi, përveç dy raporteve të Rajnhard Pribes, u shfrytëzuan edhe produktet gazetareske të agjencisë së lajmeve “[Meta](#)”, storjet e “[PINA](#)”, raportet nga vëzhgimi zgjedhor i [ASHAAM](#)-it dhe konstatimet e paraqitura në mbledhjen e grupit të fokusit të përbërë nga profesionistët mediatikë për nevojat e këtij projekti.

## Konstatimet kyçe nga vëzhgimi

E filluar, mirëpo  
e përealizuar

### 1. Transmetuesi publik i radiodifuzionit

Në kuadër të shtyllës së parë të RUP në fushën e mediave, janë dhënë rekomandime të qarta:

“ - të sigurohen dëshmi të dukshme për reformat aktuale në transmetuesin publik të radiodifuzionit në aspekt të politikës së punës, organizimit, edukimit dhe redaksisë, që kanë për qëllim marrjen me kritikën që janë theksuar rregullisht në të kaluarën në lidhje me mungesën e pavarësisë politike, mungesës së raportimit të balancuar, si dhe sigurimit të përmbajtjeve informative, me cilësi të lartë.”

1.1. Me heqjen e taksës për radiodifuzion nëpërmjet ligjit<sup>8</sup>, të cilën qytetarët nuk e paguajnë që nga tetori i vitit 2017, nuk u bënë ndryshime të konsiderueshme në funksionimin e transmetuesit publik – RTM-së. Financimi i RTM-së në tre muajt kur nuk u paguajt taksa për radiodifuzion (tetor, nëntor dhe dhjetor) u plotësua nëpërmjet buxhetit të RM-së, me rebalancin<sup>9</sup> e votuar në gusht të vitit 2017, me ç'rast u siguruan 200 milionë denarë. Buxheti për vitin 2018 u votua në dhjetor të vitit 2017, me të cilin janë paraparë mjete për financimin e: transmetuesit publik (RTM), Radiodifuzionit të Maqedonisë (RTM), dhe të organit rregullator – Agjencisë për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike (ASHAAM). Përkundër paralajmërimeve se me hapin e këtillë RTM-ja do të punojë e pavarur pa asnjë ngarkesë, problemet e grumbulluara financiare reflektohen në punën e transmetuesit publik. Për shkak të detyrimeve të mëparshme të papaguara në bashkëpunimin e saj ndërkombëtar me institucionet e ngjashme, zvogëlohet qasja në përmbajtjet me karakter ndërkombëtar. I tillë është rasti me borxhet ndaj Unionit evropian të radiodifuzionit (UER) - (EBU)<sup>10</sup>, nëpërmjet të cilit RTM-ja ka qasje në shkëmbim për të rihetuar ngjarje ndërkombëtare evropiane, programin e filmit dhe atë dokumentar, të prodhuar nga transmetuesit e radiodifuzionit që janë anëtarë të EBU-së. Përveç kësaj RTM-ja ka një shumë të konsiderueshme të borxhit ndaj DHP-së, ku gjendet në listën e të ashtuquajturve borxhlinj të mëdhenj. euro. Për këtë gjendje [RTM-ja njoftoi](#)<sup>11</sup> se problemi me borxhet do të ishte zgjidhur sikur UJP-ja të mos i kishte borxh prej 34 milionë eurosh RTM-së. Në fakt DHP-ja e ka llogaritur tatimin e RTM-së sikur të jetë paguar 100% e taksës për radiodifuzion, në përputhje me dispozitat pozitive ligjore, edhe pse DHP-ja si tubuese e tatimit ka të dhëna të sakta për shumën e paguar për taksën për radiodifuzion, e cila asnjëherë nuk ka qenë e arkëtuar 100%. Duke pasur parasysh faktin se mënyra e re e financimit është në fuqi vetëm disa muaj, akoma nuk mund të vlerësohen efektet e saj dhe sa vendosja në këtë mënyrë e organit kyç rregullator dhe e transmetuesit publik

<sup>8</sup> Propozim-ligji për ndryshimin e Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, me procedurë të shkurtuar <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=d9c2f24d-4522-4e39-aab6-0c9bf85ebbd9>

<sup>9</sup> Propozim-ligji për plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017, me procedurë të shkurtuar, Teksti i plotë i materialeve (fq. 10 dhe fq.18) <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=5744d501-53b7-4717-9f46-58c63e167a06>

<sup>10</sup> M. Atanasoska-Manasieva. (26.10.2017.) RTM-ja zhytet në borxhe, UER-i fut sanksione dhe ndalesa. Observatori për reforma mediatike. <http://mediaobservatorium.mk/sq/rm-ja-zhytet-ne-borxhe-uer-i-fut-sanksione-dhe-ndalesa/>

<sup>11</sup> Meta.mk (03.11.2017.) RTM-ja: Ne kemi borxh të madh, mirëpo edhe DHP-ja na ka borxh 34 milionë euro. <http://meta.mk/mrt-nie-dolzime-mnogu-ama-i-ujp-ni-dolzhi-34-milioni-evra/>



të radiodifuzionit është në harmonizim me rekomandimet e Këshillit të Evropës, sipas të cilave parashihet pavarësia e tyre politike dhe sistem i qëndrueshëm i financimit të pavarur.

1.2. Ndjekja e raporteve financiare të RTM-së, si dhe [analizat](#)<sup>12</sup> për punën e saj financiare kundrejt mënyrës së financimit, tregojnë se gjendja në RTM është brengosëse. Edhe përkundër reagimeve<sup>13</sup> për gjendjet e këtilla në transmetuesin publik, asnjëra nga palët e interesuara dhe ato përgjegjëse nuk publikuan ndonjë plan për tejkalimin e gjendjeve. Me ndryshimet paraprake ligjore të bëra në qershor, RTM-ja duhet të emetojë kanal të katërt, ku është planifikuar të emetohet program vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa programet në gjuhët e bashkësive të tjera etnike do të emetohen në kanal in ekzistues. Për organizimin e këtyllë programor, si dhe për gjendjen me ekipin kadrovik të transmetuesit publik është diskutuar edhe [brenda në RTM](#)<sup>14</sup> edhe në [debatin](#)<sup>15</sup> kushtuar gjendjeve në RTM organizuar nga OSBE-ja në nëntor të vitit 2017.

1.3. Në përputhje me rekomandimet e lartpërmendura nga Raporti i Pribes, gjegjësisht dy raportet dhe [planin "3-6-9"](#), qeveria filloi proces për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike. Edhe pse sipas planit të ministrisë përkatëse, forma finale e këtij propozim-ligji duhej të ishte gati më së voni deri më 30 nëntor të vitit 2017<sup>16</sup>, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë (MSHIA-ja) informoi se është përgatitur [versioni përfundimtar i Ligjit](#)<sup>17</sup>, për të cilin pritet të hyjë në procedurë qeveritare, e pastaj edhe në atë kuvendore. Më 27.12.2017 [zëdhënësi i qeverisë e njoftoi publikun](#)<sup>18</sup> se propozim-ligji për ASHAAM-in është dërguar në Komisionin Evropian (KE) për shqyrtim dhe vlerësim. Nga qeveria informuan se në qoftë se KE-ja ka propozime dhe përmirësime, MSHIA-ja do të duhej t'i shtojë ato në tekstin ekzistues, para se ai të vijë në rend dite në mbledhjen e qeverisë. Me të pritet të zgjidhen situatat dhe problemet që janë theksuar nga institucionet e ndryshme relevante ndërkombëtare, e të cilat kanë të bëjnë me implementimin e rregullativës ligjore, si dhe me funksionimin e organit rregullator dhe të transmetuesit publik të radiodifuzionit. MSHIA-ja dhe ministri pa resor i angazhuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë organizuan [debat konsultues](#)<sup>19</sup> ku u diskutua për nevojën për ndryshim dhe

<sup>12</sup> M. Atanasoska-Manasieva. (26.10.2017.) RTM-ja zhytet në borxhe, UER-i fut sanksione dhe ndalesa. Observatori për reforma mediatike. <http://mediaobservatorium.mk/sq/rtm-ja-zhytet-ne-borxhe-uer-i-fut-sanksione-dhe-ndalesa/>

<sup>13</sup> Meta.mk (31.10.2017.) SHGM: Qeveria urgjentisht ta paguajë borxhin e RTM-së që të mos shkëputemi nga UER-i. <http://meta.mk/znm-vladata-itno-da-go-namiri-dolgot-na-mrt-za-ne-bideme-otsecheni-od-ebu/>

<sup>14</sup> M. Atanasoska-Manasieva (30.11.2017) TVM-ja merr frymë në aparate të vjetra, ka video-sinjal të dobët, ndërsa për audio të dytë as që e ka idenë, Observatori për reforma mediatike. <http://mediaobservatorium.mk/sq/tvm-ja-merr-fryme-ne-aparate-te-vjetra-ka-video-sinjal-te-dobet-ndersa-per-audio-te-dyte-as-ge-e-ka-idene/>

<sup>15</sup> Observatori për reforma mediatike (27.11.2017), Programet e RTM-së në gjuhët e nacionaliteteve mezi se i mbulojnë harxhimet mujore, <http://mediaobservatorium.mk/programite-na-mrt-na-jazitsite-na-natsionalnostite-edvaj-sostavuvaat-kraj-so-kraj/>

<sup>16</sup> Njoftim për fillimin e procesit për përgatitjen e Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike. ENER. [https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_ann\\_detail&itemid=KNDpcXvO3NdR8vnXlc7Xxw==](https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_ann_detail&itemid=KNDpcXvO3NdR8vnXlc7Xxw==)

<sup>17</sup> MSHIA, Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike, [http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/zakoni/ID\\_ZA\\_AAVMU\\_25122017.pdf](http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/zakoni/ID_ZA_AAVMU_25122017.pdf)

<sup>18</sup> Observatori për reforma mediatike, <http://mediaobservatorium.mk/zakonot-za-avmu-ke-odi-na-razgleduvane-vo-evropskata-komisija-pa-potoa-vo-vlada/>

<sup>19</sup> Observatori për reforma mediatike (21.12.2017) <http://mediaobservatorium.mk/sq/shoqatat-e-gazetareve-jane-kunder-legjislacionit-qeveritar-kerkojne-veterregullim/>

plotësim të [Ligjit për media](#)<sup>20</sup>. Reagimet e publikut [mediatik](#)<sup>21</sup> dhe atij [profesional](#)<sup>22</sup> ishin të qarta se nuk ka nevojë për asnjë ndryshim të Ligjit për media, madje edhe e hodhën poshtë nevojën për ekzistimin e këtij ligji.

---

<sup>20</sup> ASHAAM, Ligji për media i datës 26.12.2013 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për media i datës 23.1.2014 <http://avmu.mk/%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD-%D0%B7%D0%B0-%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%83%D0%BC%D0%B8/>

<sup>21</sup> Nova TVB (21.12.2017) <http://novatv.mk/debata-za-izmeni-na-zakonot-za-mediumi-i-regulatsija-na-portalite/>

<sup>22</sup> Observatori për reforma mediatike (22.12.2017) <http://mediaobservatorium.mk/trajchevski-portalite-nema-potreba-da-se-reguliraat-tuku-samo-da-se-registriraat/>

Pjesërisht e  
realizuar

## 2. Reklamimi qeveritar

Sipas RUP, në fushën e “reklamimit qeveritar”, RM-ja duhet t’i përmbushë këto gjëra:

- të vendosen rregulla të rrepta për reklamimin qeveritar, të bazuara në kritere transparente, objektive dhe jodiskriminuese;
- të sigurohet transparencë e plotë e reklamimit qeveritar (jo vetëm në aspekt të shpenzimit të parave publike, por edhe në aspekt të pranuesve të tyre dhe përmbajtjeve);
- të zhvillohet një mekanizëm për shpalljet falas në transmetuesin publik të cilat me të vërtetë janë me interes publik”.

Në periudhën e përfshirë me këtë raport, nuk kishte precizime plotësuese në lidhje me masën e miratuar nga qeveria më 22.08.2017, me të cilën u publikua se hiqen të gjitha reklamat qeveritare në media.

- Deri më 31.12.2017 qeveria nuk ka publikuar dokumente zyrtare (p.sh. rregullore, procedura ose protokolle) me të cilat në mënyrë precize do t’i përcaktonte rregullat për reklamim qeveritar në rastet e lejuara me masën e lartpërmendur qeveritare, p.sh. reklamat në rrjetet sociale që janë përmendur si përjashtim.
- Në periudhën e njëjtë, qeveria nuk ka publikuar mekanizëm për të siguruar transparencë të plotë në reklamimin qeveritar, p.sh. duke miratuar rregullativë apo masa që e bëjnë të detyrueshme të publikimin e raporteve periodike (mujore ose tremujore) për aktivitetet e realizuara dhe shpenzimet në këtë sferë.
- Deri në fund të 2017, qeveria nuk ka publikuar se ka miratuar dokument zyrtar (rregullore, akte nënligjore apo të ngjashme) me të cilin do të përcaktoheshin kriteret për definimin e termit interes publik dhe temave përkatëse me interes publik, për të cilat do të komunikojë me qytetarët nëpërmjet publikimeve pa pagesë në transmetuesin publik të radiodifuzionit.

Në periudhën e ndjekjes dhe të raportimit (01.10 – 31.12.2017) nuk është vërejtur komunikim me publikun as nëpërmjet transmetuesit publik. Mirëpo, vërehet prezenca e ministrive të caktuara në “Facebook”, me faqet e tyre<sup>23</sup>. Aktiviteti i tyre është në funksion informativ me të cilin publiku informohet për aktivitetet e realizuara. Sasia, cilësia dhe arsyeshmëria e informatave nëpërmjet “Facebook”-ut nuk ishin temë e analizës në periudhën e ndjekjes dhe të raportimit për këtë fushë të RUP.

Nga qeveria deri në fund të tremujorit (31.12.2017), gjegjësisht periudhës së raportimit, nuk u dhanë sqarime të detajuara për disa veçori në lidhje me këtë problematikë dhe akoma mbetën të paprecizuara disa çështje në lidhje me aktivitetet e qeverisë në periudhën e pas miratimit të masës së lartpërmendur:

<sup>23</sup> [https://www.facebook.com/makedonskapolicija/?ref=br\\_rs](https://www.facebook.com/makedonskapolicija/?ref=br_rs); <https://www.facebook.com/zdravstvomk/>; [https://www.facebook.com/MacedoniaMOEPP/?ref=br\\_rs](https://www.facebook.com/MacedoniaMOEPP/?ref=br_rs); <https://www.facebook.com/Министерство-за-финансии-421435214560660/>; <https://www.facebook.com/Ministerstvo.za.kultura/>; [https://www.facebook.com/obrazovanieinauka/?hc\\_ref=ARSOC7rO9UCqVdpznpbgAp3luqCrEE5KbFWsmMl8uwikTcVyGrdKsk4Znkn7ZTUIHU&fref=nf](https://www.facebook.com/obrazovanieinauka/?hc_ref=ARSOC7rO9UCqVdpznpbgAp3luqCrEE5KbFWsmMl8uwikTcVyGrdKsk4Znkn7ZTUIHU&fref=nf);

- 2.1. A ka paguar, a paguan ose a planifikon të paguajë qeveria, dhe në çfarë mase, si dhe sipas cilave kritere, për produksionin e reklamave (audio-klipe, video-spote, publikime grafike etj.) për komunikim me publikun nëpërmjet transmetuesit publik të radiodifuzionit - RTM?
- 2.2. A ka paguar, a paguan ose a planifikon të paguajë qeveria e cila informoi se do të komunikojë me publikun nëpërmjet rrjeteve sociale, për produksionin e video-klipeve ose shpalljeve reklamuese, të cilat pastaj do të publikohen si postime apo reklama të paguara në "Facebook", "Twitter" dhe në rrjetet e tjera sociale dhe shërbimet e huaja për reklamim në internet?

Pjesërisht e  
realizuar

### 3. Qasja te informatat

Për fushën e qasjes në informatat me karakter publik, në kuadër të RUP kërkohet:

- “të trajtohen pengesat kryesore me të cilat përballen gazetarët gjatë marrjes së informatave publike (p.sh. mosarritja e organeve relevante që të përgjigjen në shumë kërkesa për informata, përdorimi i tepërt pa arsye i termit “sekret” për dokumentet të nuk kanë natyrë të tillë)”.

Pas publikimit të planit “3-6-9” të qeverisë së RM-së më 4 korrik të vitit 2017, sa i përket RUP u sollën një sërë masash për përmirësimin e qasjes në informatat me karakter publik me të cilat avancohet liria e të shprehurit: qasje e hapur nëpërmjet internetit në [mbledhjet e qeverisë](#)<sup>24</sup>, qasje falas për gazetarët në Regjistrin qendror dhe Kadastrën e RM-së. Këto masa sollën lehtësim të pjesërishtëm gjatë qasjes në informatat me karakter publik, për shkak se vlejné për institucione që kanë informata me karakter publik, mirëpo vlejné vetëm për një kategori të qytetarëve, gjegjësisht për gazetarët dhe punëtorët mediatikë. Siç u theksua në [Raportin e parë periodik të Observatorit për reforma mediatike](#) (fq. 12 dhe fq. 13), një sërë palësh tjera të interesuara, të cilat, poashtu, realizojné aktivitete me interes publik, siç janë ekipet hulumtuese, bashkësia akademike dhe sektori i OJQ-ve, ekologjistët etj., mbeten të përjashtuar nga kjo qasje.

Në periudhën e ndjekjes së RUP (01.10.-30.12.2017) nuk janë bërë përmirësime të konsiderueshme sa i përket procedurës dhe precizimit të disa paqartësive. Sipas sqarimeve të institucioneve të përfshira me masat e lartpërmendura, kjo qasje falas i përjashton gazetarët e lirë, për shkak se ata nuk kanë redaksi nga e cila do të dorëzonin letër, e cila është e domosdoshme gjatë kërimit të qasjes falas. Poashtu, nuk është theksuar se kush është personi i autorizuar apo funksioni që ka kompetencë ta refuzojë kërkesën për qasje të lirë në informata në dy institucionet e lartpërmendura dhe në cilat kushte mund të refuzohet kërkesa e tillë nga ana e institucionit – posedues i informatave me karakter publik.

Gjatë periudhës së ndjekjes të përfshirë me këtë raport, organizatat e shoqërisë qytetare në disa raste e kanë potencuar domosdoshmërinë për ndryshime dhe plotësime të Ligjit ekzistues për qasje në informatat me karakter publik. Këto kërkesa u paraqitën publikisht edhe gjatë diskutimit në kuadër të prezantimit publik të rezultateve nga monitoringu i Raportit të parë periodik të Observatorit për reforma mediatike të mbajtur në kuadër të konferencës ndërkombëtare e-Shoqëri.mk<sup>25</sup> (22.11.2017), ku morën pjesë edhe përfaqësues të ministrive kompetente dhe të organeve rregullatore.

Sfidat kryesore që i theksuan organizatat qytetare dhe ekspertët e kësaj fushe janë përmbledhur në dokumentin për politikë publike [“Propozime për ndryshimin e Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik dhe përmirësimi i zbatimit të tij”](#)<sup>26</sup> të publikuar nga FSHM-ja. Si probleme kryesore nga zbatimi i Ligjit që duhet të tejkalohen janë: niveli i ulët i vetëdijes publike për të drejtën e qytetarëve për qasje të lirë dhe ligji që e mundëson këtë; heshtja e administratës, që ndërlihet

<sup>24</sup> Qeveria e RM-së. Mbledhjet e qeverisë. <http://vlada.mk/vladini-sednici>

<sup>25</sup> Dokumentacioni i plotë për konferencën “e-Shoqëri.mk: Liria dhe privatësia në internet” gjendet në ueb-faqen <http://e-society.mk>, fotografitë nga ngjarja gjenden në: <https://www.flickr.com/photos/fosim/albums/72157690877281666> ndërsa video-incizimi nga ngjarja në faqen: <https://www.youtube.com/user/fmetamorphosis/videos>.

<sup>26</sup> “Propozime për ndryshimin e Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik dhe përmirësimi i zbatimit të tij” (12.01.2018) <http://fosm.mk/CMS/Files/Documents/Policy%20Brief%2012-01-2018.pdf>

edhe me mosndëshkimin e injorimit të kërkesave të institucioneve; kapaciteti i ulët i poseduesve të informatave si shkak për vështirësitë në implementimin e ligjit; mungesa e buxhetit, kapacitetit dhe efikasitetit të Komisionit kompetent<sup>27</sup>.

Në [debatin publik](#)<sup>28</sup> për nevojën për ndryshime në Ligjin për qasje të lirë në informatat me karakter publik të organizuar nga Ministria për Drejtësi më 19.12.2017, u dhanë vërejtje dhe u prezantuan të dhëna që shkojnë në favor të nevojës për ndryshim të ligjit ekzistues. Gjatë vitit 2017 nga 700 ankesa të parashtruara deri te Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje në informata, mbi 500 kanë pasur të bëjnë me heshtjen e administratës.

Në periudhën e raportimit (1.10.-30.12.2017) qeveria paralajmëroi ndryshim dhe plotësim të Ligjit për qasjen e lirë në informatat me karakter publik, gjë që u kërkua disa herë nga organizata të ndryshme qytetare dhe punëtorë mediatikë gjatë periudhës së kaluar. Për këtë qëllim, MSHIA-ja me Ministrinë për Drejtësi dhe ministrin pa resor të angazhuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë, në një [komunikatë për publikun](#)<sup>29</sup> u bëri thirrje qytetarëve, mediave dhe organizatave qytetare që të japin propozime dhe sugjerime për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për qasje në informatat me karakter publik.

---

<sup>27</sup> Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik i Republikës së Maqedonisë. <http://komspi.mk/>

<sup>28</sup> Observatori për reforma mediatike, (19.12.2017) <http://mediaobservatorium.mk/administratsijata-najmalku-odgovara-na-novinarskite-prashana/>

<sup>29</sup> Observatori për reforma mediatike (20.12.2017) <http://mediaobservatorium.mk/povik-za-predlozi-i-sugestii-za-noviot-zakon-za-sloboden-pristap-do-informatsii/>

Fare e  
perealizuar

## 4. Shpifja

Reformat prioritare për mediat në fushën e katërt – shpifja – parashohin:

“...zvogëlim të numrit të rasteve të shpifjes që arrijnë në gjykata, gjë që duhet të arrihet me: ndryshim të legjislacionit që të largohen rastet e llojit “nderi”, “dinjiteti” dhe “ofendimi”, të cilat iniciohen në përputhje me definicionin ligjor të ofendimit, mirëpo të cilat janë jashtë diapazonit të ofendimit në kuptim të nenit 10 të KEDNJ-së; ndryshim të rregullave procedurale për përjashtimin e rasteve të vogla, dhe në vend të kësaj të ketë rritje të zbatimit të ndërmjetësimit gjatë zgjidhjes së tyre; ndryshim dhe promovim të përdorimit më të madh të vetërregullimit si alternativë për shqyrtimin gjyqësor; garantim dhe zbatim, në nivel politik të praktikimit të vetëkufizimit adekuat nga politikanët dhe funksionarët publikë që të mos iniciohet procedurë për shpifje, në përputhje me parimet e GJEDNJ-së”.

Sipas raportit të fundit të Pribes të vitit 2017<sup>30</sup>, i cili ndërlidhet me raportin e vitit 2015<sup>31</sup>, është regjistruar zvogëlim i rasteve gjyqësore për shpifje dhe për këtë pjesë të pakos reformuese thuhet se nuk trajtohet si fushë që brengos më së shumti.

Në periudhën e ndjekjes dhe raportimit për RUP (01.10-31.12.2017) nuk ka asnjë ndryshim që nga publikimi i [Raportit të parë periodik](#) i Observatorit për reforma mediatike (fq. 14) që do të tregonte se ka avancim të gjendjeve në fushën e padive për shkak të shpifjes dhe ofendimit, me të cilat u përballën gazetarët dhe punëtorët mediatikë. Nuk ka as paralajmërim për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim.

<sup>30</sup> Senior expert group. (14.09.2017.) The former Yugoslav Republic of Macedonia: Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues 2017. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14\\_seg\\_report\\_on\\_systemic\\_rol\\_issues\\_for\\_publication.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf) fq.24, paragrafi 122

<sup>31</sup> Komisioni Evropian, DGJ Politika evropiane për fqinjësi dhe negociatat për zgjerim. Reformat urgjente prioritare për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (qershor 2015) [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent\\_reform\\_priorities\\_mk.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf)

## Literatura e shfrytëzuar

- Przino Agreement – Agreement in Skopje to overcome political crisis, 2 June 2015, Skopje.
- Prioritetet për reformat urgjente për Republikën e Maqedonisë, Komisioni Evropian, DGJ Politika evropiane për fqinjësi dhe negociatat për zgjerim, qershor 2015.
- Programi për punë i Qeverisë së RM-së, 2017- 2020.
- Plani “3-6-9” i Qeverisë së RM-së, 2017-2018.
- Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in spring 2015.
- Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues, 2017.
- Fondacioni Shoqëri e hapur - Maqedoni. “Propozime për ndryshimin e Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik dhe përmirësimi i zbatimit të tij” (12.01.2018)